



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISE LIGJORE

Nr. 2019/Prot
/4

Tiranë më 06.12.19.

VENDIM

Nr. 11, datë 06.12.19.

Për

Miratim të dy tipeve të instrumentave matës

1- Peshore Automobilistike TPA 2- Peshore Platforme TPP

Në mbështetje të ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 "Për Metrologjinë", neni 22 dhe 31, dhe ligjit Nr. 9779, date 16.07.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore", neni 9 dhe neni 15; bazuar në Urdhërin e Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës Nr.196, datë 9.03.2009, "Rregullore për miratimin e tipit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara", neni 41, pika 5, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit për njohjen e miratimit të tipit

VENDOSA:

1. Miratim të tipeve të instrumentave matës:

- 1- Peshore Automobilistike TPA
- 2- Peshore Platforme TPP

Prodhuar , montuar dhe hedhur në treg nga **TUNAMAR Sh.p.k** NIPT L42610208C me adresë kryesore sipas çertifikatës së regjistrimit : Elbasan ,Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, Rruga Kadri Hoxha, Zona kadastrale 2346, Pasuria nr.428/5/4.Elbasan

1-Këto 2 (dy) tipe instrumentesh matës janë në përputhje me kërkesat teknike metrologjike ligjore të përshkruara në Standardin Ndërkombëtar **SSH EN 45501:2015**, të rekomandimeve të **OIML-së R 76-1, Edition 2006**, në Përputhje me kërkesat e Rregullores së Instrumentave të Peshimit Jo -Automatik Nr 2000 (SI 2000/3236), në zbatim të Direktivës 2009/23/EC dhe 2014/31/EU, të Këshillit European.

2-Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë miraton 2 (dy) Tipet e këtyre instrumentave Jo Automatike të Peshimit prodhuar, montuar dhe çertifikuar: në përputhje me Standartet dhe Rekomandimet Ndërkombëtare, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

3. Keto tipe instrumentesh lejohen te vendosen ne treg dhe vihen ne perdorim per qellime te parashikuara ne nenin 18, pika 1, te Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008 "Per Metrologjine".

4. Instrumentet mates i nenshtrohen kontrollit metrologjik ligjor sipas legjislacionit ne fuqi.

5. Shenja e miratimit te tipit jepet ne fleten bashkangjitur ketij vendimi.

Leshuar me 06/12/ 2019.

Shenjat e miratimit te tipeve

1-Peshore Automobilistike TPA

012 **S** AL19

2- Peshore Platforme TPP

013 **S** AL19

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Petrit RAMA

